



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS PËR VIZITËN NË QENDRËN E PARABURGIMIT NË PEJË

Për: Znj. Albulena Haxhiu, ministre
Ministria e Drejtësisë
Z. Arben Vitia, ministër
Ministria e Shëndetësisë
Z. Albert Zogaj, kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Z. Jetish Maloku, kryesues
Këshilli Prokurorial i Kosovës

Kopje: Znj. Duda Balje, kryetare,
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe
Peticione
Z. Habit Hajredinaj, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë
Z. Rasim Selmanaj, drejtor i përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës
Z. Milazim Gjocaj, drejtor
Departamenti për Shëndetësinë në Burgje
Z. Samedin Mehmeti, drejtor
Policia e Kosovës
Z. Jeton Mehmetaj, drejtor
Qendra e Paraburgimit në Pejë

Prishtinë, më 03 shtator 2021

1. Në pajtim me nenin 17 të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 25 maj 2021 ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Pejë (QPP).
2. Të burgosurit janë të vendosur në krahët A, B, C dhe D. Kapaciteti i zyrtar i QPP-së është për 80 persona. Në kohën kur MKPT-ja e vizitoi këtë qendër, aty ishin të vendosur 71 të burgosur, prej tyre 12 të dënuar.

Përbërja e grupit monitorues

3. Grupi monitorues përbëhej nga:
 1. Drejtoresha e MKPT-së.
 2. Këshilltari i lartë juridik për parandalim të torturës.
 3. Këshilltare për parandalim të torturës.
 4. Këshilltare-mjeke.
 5. Këshilltare-punëtore sociale.
 6. Këshilltare-psikologe.
 7. Zyrtari i Këshillit të Evropës, në cilësi të vëzhguesit.

Qëllimi i vizitës

4. Qëllimi kryesor i vizitës ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të njeriut të të burgosurve të akomoduar në QPP, në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitës

5. Gjatë vizitës së QPP-së nga MKPT-ja, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e QPP-së. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa prezencë të zyrtarëve korrektues ose të personelit tjetër.

Trajtimi i të burgosurve

6. MKPT-ja, gjatë vizitave në QPP, ka intervistuar një numër të të paraburgosurve dhe të të dënuarve dhe nuk ka marrë asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. Komunikimi interaktiv në mes të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues ishte në nivel të kënaqshëm.
7. MKPT-ja ka marrë një numër të vogël ankesash për keqtrajtim nga zyrtarët policor të Kosovës gjatë procesit të arrestimit. Lidhur me këto pretendime, MKPT-ja ka kontrolluar dosjet mjekësore të ankuesve në të cilat nuk u gjeten dëshmi lidhur me pretendimet në fjalë. Sidoqoftë, ankuesit u njoftuan nga MKPT-ja për të drejtën e tyre për të parashtruar ankesë në Inspektoratin Policor të Kosovës lidhur me pretendimet për keqtrajtim nga policia.

8. MKPT-ja ka marrë ankesa nga të paraburgosurit lidhur me kohëzgjatjen e paraburgimit dhe mosveprim nga prokuroria kompetente. Duke mos paragjykuar nëse këto ankesa janë të bazuara apo jo, MKPT-ja, përmes këtij raporti, duke mos paragjykuar pretendimet e ankuesve, e sheh të arsyeshme dhe të nevojshme që t'i njoftojë organet kompetente për ankesat që i ka marrë nga të burgosurit.
9. MKPT-ja ka marrë ankesë nga i dënuari Z. Q., i cili ka pohuar se çdo gjashtë muaj i bëhet vlerësimi për rrezikshmëri, ndërsa ankuesi pretendon se i mbetet e njëjta kategori (rrezikshmëri e lartë) për 7 vjet, përkundër që ankuesi nuk kishte asnjë masë disiplinore brenda këtyre 7 vjetëve. Gjithashtu pretendon se për shkak të veprës për të cilën u dënua, që dy vjet prej që është akomoduar në QPP, ai qëndron i mbyllur në qeli pa asnjë angazhim apo aktivitet tjetër.
10. Ankuesi gjithashtu e ka potencuar edhe mungesën e titujve të mjaftueshëm të literaturës në bibliotekën e burgut. Ankuesit ka thënë se iu morën të gjitha librat që i ka sjellë nga shtëpia, me arsyetimin se nuk përfshihen në listën e librave të aprovuara nga burgu.
11. I njëjti i burgosur ka thënë se bastisjet në dhomën e tij bëhen nga një zyrtar korrektues dhe gjatë kohës kur i burgosuri nuk është në dhomë. Lidhur me bastisjet e dhomave të të burgosurve, MKPT-ja, duke mos paragjykuar për pretendimin e të burgosurit, ua rikujton autoriteteve të QPP-së se në raste të bastisjeve të dhomave të të burgosurve duhet të vepohet në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP).

Kushtet e akomodimit

12. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vizituar një numër të qelive dhe ka verifikuar se hapësirat e akomodimit, ndriçimit dhe ventilimit nuk janë në pajtim me LESP¹ dhe as me standardet e përcaktuar nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT).²
13. MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se dhomat e të burgosurve ishin gëlqerosura, në kuadër të përpjekjeve të QPP-së për të krijuar kushte më të mira të akomodimit për të burgosurit. Megjithatë, MKPT-ja ka vërejtur se përkundër gëlqerosjes, disa dhoma prapë kishin lagështi. Gjatë vizitës, MKPT-ja është njoftuar se QPP-ja është furnizuar me dyshekë të rinj, çarçafë dhe jastëk. Të burgosurit mund të bëjnë dush dy herë brenda javës, kurse ata të cilët janë të angazhuar në punë mund të bëjnë dush çdo ditë. Megjithatë, gjatë vizitës është vërejtur se hapësirat ku të burgosurit bëjnë dush dhe nyjat sanitare janë në gjendje shumë të keqe dhe nevojiten renovime të menjëhershme.
14. Lidhur me kushtet e akomodimit në QPP, MKPT-ja e Avokatit të Popullit, përmes raportit me rekomandime për vizitën në QPP, e realizuar më 4 tetor 2018, i cili u publikua më 22 nëntor 2018, i kishte rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë si në vijim: *“Kushtet e akomodimit, përderisa kjo qendër është në përdorim, të jenë në pajtim me standardet minimale të përcaktuara me LESP; me standardet e KPT-së dhe me standardet tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.”*
15. MKPT-ja ka vërejtur se gjendja mbetet pothuajse e njëjtë që nga vizitat e fundit, pasi QPP-ja është një ndërtesë e vjetër, e cila daton nga vitet e 60-a dhe nuk mund të priten

¹ Ligji nr. 05/L0-129, neni 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

² Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449>.

ndryshime domethënëse sa i përket infrastrukturës, por mund të rinovohen hapësira të caktuara me qëllim të ofrimit të kushteve të akomodimit në pajtim me standardet nacionale dhe ndërkombëtare për të drejtat themelore të njeriut.

16. MKPT-ja vlerëson se autoritetet kompetente duhet të kenë një plan lidhur me të ardhmen e QPP-së, pasi kushtet e akomodimit në këtë qendër konsiderohet joadekuate. Përveç raporteve me rekomandime të publikuara nga MKPT-ja e Avokatit të Popullit, kjo gjendje konstatohet edhe në raportet e KPT-së për vizitat e realizuara në Republikën e Kosovës në vitin 2007 (shih paragrafin 58), 2015 (paragrafi 41).³

Mbipopullimi

17. MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se kjo qendër nuk përballet me mbipopullim dhe se numri i të burgosurve të akomoduar është nën kapacitetin zyrtar të QPP-së.

Regjimi

18. Në QPP tash për tash janë të angazhuar në punë rreth 8 të paraburgosur dhe tre të dënuar. Të paraburgosurit mund të dalin në ajrosje (shëtitje) dy herë në ditë, në kohëzgjatje prej 1 ore.⁴ QPP-ja posedon një shëtitore mjaft të vogël, në të cilën gjendet vetëm një tabelë e pingpongut.
19. QPP-ja nuk ka mundësi që të paraburgosurve dhe të dënuarve t'u ofrojë aktivitete të tjera, përveç shëtitjes dhe shikimit të TV-së në qeli. Kështu që, të paraburgosurit dhe të dënuarit shumicën e kohës së tyre e kalojnë të mbyllur në qelitë e tyre. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka pranuar ankesa nga të burgosurit për shkak të numrit të vogël të kanaleve televizive në dispozicion të të burgosurve.
20. MKPT-ja vlerëson se regjimi për të paraburgosurit mbetet i varfër, pavarësisht përpjekjeve të drejtorisë për të ofruar më shumë aktivitete për të paraburgosurit. Për më shumë, në rastin e të paraburgosurve shpesh nevojitet leja nga gjykata kompetente, në mënyrë që ata të angazhohen në punë ose në ndonjë aktivitet specifik.
21. MKPT-ja përmes raporteve të mëhershme për vizitat në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria e tyre ka theksuar domosdoshmërinë e sigurimit të një regjimi gjithëpërfshirës për të burgosurit (në të cilin përfshihen edhe të paraburgosurit) për të siguruar se të gjithë të burgosurit kalojnë një kohë të arsyeshme jashtë qelive të tyre të përfshirë në aktivitete, siç janë: puna, edukimi, sporti, rekreacioni apo shoqërimi me të burgosurit e tjerë.⁵

Kontaktet me botën e jashtme

22. Legjislacioni në fuqi⁶ për rastin e personave të dënuar përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar të korrespondencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe për

³ Për më shumë shih raportet e plota në: <https://rm.coe.int/16806alefc> për vizitën në vitin 2015 dhe në: <https://rm.coe.int/168069727c> për vizitën në vitin 2007.

⁴ Rregullat e Mandelës, neni 23. Rregullat Evropiane të Burgjeve, neni 27.1. Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, paragrafi 48, publikuar në vitin 2015. Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë për së paku dy orë shëtitje në ditë.

⁵ Raporti i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës për vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë, publikuar më 19 qershor 2017, paragrafi 20. Shih në: <https://oik-rks.org/2018/01/31/raport-i-mkpt-per-viziten-ne-burgun-e-sigurise-se-larte/>

⁶ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të telefonuar.

23. Lidhur me telefonatat, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese⁷ përcakton se i dënuari ka të drejtë për biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Sipas këtij udhëzimi, biseda telefonike e personit të dënuar dhe të paraburgosur nuk mund të jetë më e gjatë se 15 minuta.
24. Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita “*brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit*”, bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej Kodi përcakton se korrespondenca dhe vizitat e tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake.
25. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t’i vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta, pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, të gjyqtarit të vetëm gjykues apo të kryetarit të trupit gjykues, ose të personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit.
26. Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që me shkrim ose me gojë të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike apo me zyrën përkatëse të shtetit, i cili mban shtetësinë e atij shteti.⁸ Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se për shkak të paraqitjes së pandemisë COVID-19, autoritetet u detyruan t’i ndalonin dhe t’i kufizonin vizitat familjare. Megjithatë, për të zbutur këtë kufizim, të burgosurve iu lejuan më shumë telefonata dhe komunikimi përmes SKYPE. Po ashtu, këto masa gjatë gjithë kohës u rishqyrtuan kohë pas kohe varësisht nga gjendja me pandeminë COVID-19 dhe rekomandimet e organeve kompetente shëndetësore.
27. Edhe përmes këtij raporti, MKPT-ja inkurajon autoritetet kompetente që të vazhdojnë me ofrimin e mundësisë për të komunikuar përmes SKYPE, sidomos në rastet e të burgosurve, familjarët e të cilëve për shkaqe ekonomike nuk mund t’i vizitojnë dhe në rastet e shtetasve të huaj.

Kujdesi shëndetësor

28. Sa i përket personelit në dispozicion, MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se në përbërje të njësisë shëndetësore është një mjek i rregullt me orar të plotë të punës (08:00-16:00) dhe në thirrje. Po ashtu janë edhe 6 infermierë me orar 12 orësh, ndërsa kryeinfermieri me orar 08:00-16:00. Konsultat me psikiatrin dhe me psikologun janë në dispozicion një herë brenda javës. Për shërbime të tjera mjekësore, të burgosurit dërgohen në institucione të tjera publike shëndetësore sipas rekomandimit. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga të paraburgosurit dhe të dënuarit lidhur me kujdesin shëndetësor.
29. Megjithatë, infrastruktura ku realizohen shërbimet mjekësore nuk i plotëson as kushtet minimale, mungon drita natyrale, nuk ka dhomë të veçantë për vizitë të pacientëve apo aplikim të terapisë. Higjiena mbahej nga vetë infermierët. Transporti i të burgosurve për

⁷ Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

⁸ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 33, paragrafi 1.

të marrë shërbime mjekësore në institucionet e tjera shëndetësore jashtë QPP-së bëhet me automjete të Shërbimit Korrektues.

Regjistrat

30. Njësia shëndetësore në QPP i ka të evidentuara të gjitha protokollet e duhura. MKPT-ja ka vërejtur regjistrat si në vijim: dosja mjekësore e pacientit, regjistri i infermierit me ndërrime, terapitë, ankesat apo kërkesat për vizitë të radhës te mjeku, dërgimit të pacientit për trajtim jashtë ambulancës së burgut, të vetëlëndimit, të lëndimeve trupore, të abuzimeve seksuale, grevës së urisë, të tentim-vetëvrasjes, të vetmisë, të vdekjes në burg.

Kontrolli mjekësor me rastin e pranimin të të burgosurit

31. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale⁹ dhe Praktika Standarde e Veprimeve¹⁰ e DShB-së përcaktojnë obligimin që i burgosuri i posapranuar t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimin. Bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe kontrollin e dokumentacionit relevant mjekësor, MKPT-ja ka vërejtur se njësia shëndetësore në QPP kryen kontrollet mjekësore për të burgosurit e pranuar, në pajtim me dispozitat e lartpërmendura.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

32. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me Praktikën Standarde të Veprimit,¹¹ e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale¹², me standardet e KPT,¹³ si dhe me aktet ndërkombëtare, siç janë: Rregullat e Mandelës¹⁴ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, etj.¹⁵

33. MKPT-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe me personelin shëndetësor, konstaton se këto shërbime jepen në kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përveç në raste kur prania e tyre kërkohet nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.

Procedura e parashtrimit të ankesave

34. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garanci themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut apo qendrës së paraburgimit ku akomodohen dhe që në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.

35. MKPT-ja ka vërejtur se në QPP janë të vendosura kutitë e ankesave të ShKK-së dhe kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit, të cilat u shërbejnë

⁹ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31.

¹⁰ Praktika Standarde e Veprimeve, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

¹¹ Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

¹² Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49.

¹³ Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafët 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943/>

¹⁴ Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf/

¹⁵ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf/

të burgosurve për t'i parashtruar kërkesat dhe ankesat e tyre. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.

36. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga të paraburgosurit dhe të dënuarit lidhur me çështjen e parashtrimit të ankesave apo vonesa për t'i shqyrtuar ankesat e tyre brenda afatit ligjor.


Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKPT-së gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:

- **Të krijohen kushte dhe hapësirë adekuate të punës për personelin mjekësor.**
- **Kushtet e akomodimit në QPP, përderisa kjo qendër është në përdorim, të jenë në pajtim me standardet e përcaktuara në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; me standardet e KPT-së dhe me standardet e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.**
- **Ministria e Drejtësisë ta njoftojë Avokatin e Popullit për planin e saj për QPP-në në të ardhmen.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.


Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit